




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, nenit 30 paragrafi 1 Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.10.2022, merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT për hartimin e Kartës Zonale të Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vitisë, e cila marrëveshje ka për qëllim që të siguroj një kornizë bashkëpunimi brenda së cilës UBT dhe Komuna e Vitisë do hartojnë së bashku hartën zonale dhe Raportin e vlerësimit strategjik mjedisor për Komunën e Vitisë.

Neni 2

Rezultatet kryesore të bashkëpunimit janë të cekura në marrëveshjen, neni 1, paragrafi 3.

Neni 3

Palët kanë arritur marrëveshje me njëri tjetrin, pjese e këtij vendimi është marrëveshja e bashkëpunimi ndërmjet UBT dhe Komunës së Vitisë me Nr. 02-035/02-1202, e datës 24.10.2022.

Neni 4

Pagesa bëhet nga Buxheti i Komunës së Vitisë, të cilat pagesa i ekzekuton Drejtoria për Financa, ndërsa për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim...;
3. Drejtoritë përkatëse;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi





MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KOLEGJIT UBT

DHE

KOMUNËS SË VITISË

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - GJEGËRINA VITINA

24-10-2022

Prillor	Maj	Qershor	Gjergor	Prillor	Vlera
					Wednes

02-035/02-1202

PËR HARTIMIN E "HARTËS ZONALE TË KOMUNËS- VITI"

DUKE PASUR PARASYSH QË, Kolegji UBT (më tutje referuar si "UBT") është një institucion privat i arsimit të lartë i themeluar në Prishtinë në vitin 2004, me lincencë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr. 808 / 02-1. Ai synon të ofrojë arritjet më të fundit në shkencën e menaxhimit, përsosmërinë e biznesit, teknologjinë moderne, robotikën, arkitekturën, dizajnin, planifikimin hapësinor, marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomacinë, drejtësinë, shkencat shëndetësore etj. përmes programeve të tij ndërdisiplinore dhe inovative;

DUKE PASUR PARASYSH QË, Komuna e Vitisë, Kosovë, e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (më tutje referuar si "Komuna e Vitisë"), është e angazhuar të ndërmarrë veprime që çojnë drejt zhvillimit dhe menaxhimit hapësinor dhe urbanistik të përmirësuar dhe të ndjeshëm ndaj mjedisit, të rregullojë dhe forcojë strukturat organizative të përshtatshme për planifikim strategjik dhe pjesëmarrës, si dhe të planifikojë zbatimin, përmirësimin e dialogut publik, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe bashkëpunimin ndër-komunal në mbështetje të kushteve të përmirësuara të jetesës dhe zhvillimit gjithëpërfshirës;

BAZUAR NË dispozitat ligjore neni 30 paragrafi 1 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale NR.03/L-040;

DERISA, UBT dhe Komuna e Vitisë kanë rënë dakord të bashkëpunojnë në hartimin e Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë;

DERISA, projekti Harta Zonale Komunale për Komunën e Vitisë do të mbledhë ekspertë dhe profesionistë me përgatitje të ndryshme akademike e profesionale, të cilët në bashkëpunim me Grupin Punues Bazë të Projektit (të përbërë nga stafi i UBT-së, zyrtarë të komunës dhe përfaqësues të komunitetit dhe shoqërisë civile, siç paraqitet në Shtojcën B: Grupi Punues Bazë) dhe komunitetin do të punojnë për hartimin e Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë;

DERISA, UBT dhe Komuna e Vitisë (më tutje referuar kolektivisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala") që njohin përfitimet e një bashkëpunimi të mirëfilltë, thelbësor dhe që dëshirojnë të ndjekin një bashkëpunim të tillë kanë hyrë në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit (më tutje referuar si "MB") në një frymë besimi dhe bashkëpunimi;

Palët bien dakord si më poshtë:

KUSHTET E PËRGJITHSHME

NENI I

Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të sigurojë një kornizë bashkëpunimi brenda së cilës UBT dhe Komuna e Vitisë hartojnë së bashku Hartën Zonale Komunale dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, për Komunën e Vitisë.
2. Bashkëpunimi midis Palëve në Viti, Kosovë do të implementohet me fokus në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe programi për zhvillim të gjithëmbarshtëm e të qëndrueshëm të komunës.
3. Rezultatet kryesore të bashkëpunimit janë si në vijim:
 - (a) Involvmi i stafit akademik dhe profesional të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), përfitimi nga njohuritë dhe eksperiencia e tyre për të zhvilluar strategji të mirëfillt, e bazuar në praktika të mira globale dhe në nevoja/kërkesa lokale, për t'i dhënë komunës së Vitisë kahje drejt zhvillimit të qëndrueshëm,
 - (b) Hartimi i Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, urban, socio-ekonomik dhe infrastrukturor të komunës,
 - (c) Harmonizimi i Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë me dokumentet relevante të Zhvillimit Hapësinor të Kosovës, të parapara me **Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor**, si dhe me të gjitha dokumentet tjera relevante që janë aktualisht në zbatim, si dhe me ato të planifikuara, në komunën e Vitisë,
 - (d) Përfshirja e Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë dhe programit dhe planeve të veprimit brenda agjendës së zhvillimit të Komunës së Vitisë (dokumentet e planifikimit hapësinor, strategjitë e zhvillimit dhe ciklet e buxhetimit).

NENI II

Përgjegjësitë e Përgjithshme të Palëve

1. Palët do ta mbajnë njëri-tjetrin të informuar për të gjitha aktivitetet përkatëse që i përkasin kësaj Marrëveshje dhe do të zhvillojnë konsultime në çdo kohë që Palët e konsiderojë të nevojshme.
2. Palët do të përmbahen nga çdo veprim që mund të ndikojë negativisht në interesat e Palës tjetër dhe do të përmbushin zotimet e tyre duke i respektuar plotësisht termat dhe kushtet e kësaj MB.
3. Secila palë duhet të emërojë një person kryesor kontaktues për këtë bashkëpunim siç përcaktohet në **Nenin VIII ("Njoftimet")**, klauzola (1) këtu e më poshtë.
4. Palët bien dakord që kjo MB përmbanë edhe detyrime financimi për palët. Kosto totale e projektit është 145,000.00 (Njëqind e Dyzetepesë Mijë) Euro. Nga kjo kosto 70,000.00 (Shtatëdhjetë Mijë) Euro (48.3 % e shumës totale) do të mbulohet nga Komuna e Vitisë. Ndërsa pjesa tjetër prej 75,000.00 (Shtatëdhjetë e Pesë Mijë) Euro (51,7 % e shumës totale) do të mbulohet nga UBT. Parimet e përgjithshme të pagesës për Komunën e Vitisë janë specifikuar në **Kushtet e Veçanta** të kësaj MB.

NENI III

Fushat e Bashkëpunimit në Mes të Palëve

1. Palët do të bashkëpunojnë në hartimin e Hartës Zonale Komunale si dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, përfshirë:
 - (a) Shkëmbimin dhe/apo shpërndarjen e të dhënave dhe materialeve të nevojshme për fazën analitike si dhe për fazat e përgaditjes së skenarëve zhvillimor,
 - (b) Dhënie të komenteve në lidhje me drejtimet e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinorë, urban, socio-ekonomik dhe infrastrukturor të komunës të Vitisë,
 - (c) Asistimin në zhvillimin dhe organizimin e punëtorive dhe takimeve me komunitetin,
 - (d) Pjesëmarrjen në punëtoritë e organizuara dhe në takime të ndërlidhura me komunitetin,
 - (e) Asistim në organizimin e konferencave informuese që lidhen me projektin,
 - (f) Asistimin në procedurat administrative e burokratike që lidhen me projektin,

NENI IV

Përgjegjësitë e Veçanta të Palëve

1. Përgjegjësitë e veçanta të UBT-së janë:
 - (a) Ofrimi i mbështetjes profesionale dhe organizative për hartimin e Hartës Zonale Komunale dhe Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Komunën e Vitisë, duke angazhuar staf akademik e profesional nga UBT- Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor si dhe nga fakultetet, qendrat e institutet relevante me natyrën e projektit,
 - (b) Ofrimi i mbështetjes logjistike (duke siguruar hapësirën, materialet përkatëse të nevojshme, printimin dhe pllotimin etj.),
 - (c) Organizimi i vizitave në terren,
 - (d) Organizimi i takimeve me komunitetin, në bashkëpunim me komunën e Vitisë,
 - (e) Organizimi i konferencave informuese lidhur me projektin,
 - (f) Promovimi i projektit dhe aktiviteteve të ndërlidhura me projektin.
2. Përgjegjësitë e veçanta të Komunës së Vitisë janë:
 - (a) Mbështetja e hartimit të Hartës Zonale Komunale dhe Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe udhëheqja drejt implementimit të suksesshëm të tij,
 - (b) Sigurimi i përfshirjes së zyrtarëve komunalë në kuadër të Grupit Punues Bazë të projektit,
 - (c) Koordinimi me Drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës për hartimin e Hartës Zonale Komunale dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor,
 - (d) Ndërmjetësimi në lidhjen me përfaqësuesit e komunitetit,
 - (e) Mundësimi i përdorimit të hapësirave të saj për zbatimin e punëtorive dhe takimeve që

- lidhen me projektin,
- (f) Ofrimi i mbështetjes logjistike,
 - (g) Ndërmjetësimi me Grupin Punues Bazë dhe të gjitha palët tjera të involvuara
 - (h) Promovimi i projektit dhe aktiviteteve të ndërlidhura me projektin,
 - (i) Vendosja e një shembulli të mirë për hartimin dhe zbatimin e Hartës Zonale Komunale

NENI V

Monitorimi dhe Vlerësimi

1. Palët do të mbajnë konsultime të rregullta në baza mujore për të monitoruar dhe rishikuar përparimin e aktiviteteve që janë paraparë me këtë MB.

NENI VI

Ndërprerja

1. Në rast të konstatimit se njëra nga palët nuk i ka përmbushur obligimet që dalin nga kjo Marrëveshje, Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë duke i dhënë palës tjetër njoftimin me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë para qëllimit të tij për të përfunduar. Në rast të përfundimit, Palët do të ndërmarrin hapat e duhur për të sjellë aktivitetet nën këtë MB në një përfundim të shpejtë dhe të rregullt.
2. Përfundimi i kësaj Marrëveshje nuk do të cenojë asnjë marrëveshje tjetër tashmë të nënshkruar nga Palët.

NENI VII

Forcat madhore

1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas marrëveshjes nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore (fatkeqësi natyrore, epidemi, pandemi, trazira civile, mbyllje e objektit ose çrregullime tjera industriale dhe të ngjashme) që shkaktohet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj MB.
2. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detale mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasë të kenë rrethanat.
3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arësishme për të mënjanuar paaftësinë për të përmbushur detyrimet e saj me vonesa minimale.

NENI VIII

Ndryshimet

1. Kjo MB mund të modifikohet me marrëveshje me shkrim midis Palëve të tij. Çfarëdo çështje e rëndësishme për të cilën nuk është bërë asnjë dispozitë në këtë MB do të zgjidhet nga palët në përputhje me objektivat e përgjithshëm të MB dhe në atë mënyrë që është e favorshme për vazhdimin e marrëdhënieve të mira.

NENI IX

Njoftimet

1. Çfarëdo njoftimi që kërkohet të jepet nga ndonjëra Palë e kësaj MB do të jepet me shkrim dhe do të konsiderohet se jepet kur në të vërtetë pranohet nga Pala tjetër, në adresat e mëposhtme:

Për UBT-në	Për Komunën e Vitisë
<u>Për Çështje Operative:</u> Emri: Hazer Dana Titulli: Staf Akademik në UBT Adresa: Lagjja Kalabria, 10000 Prishtinë, Kosovo Numri i Telefonit: +383 44203500 Email Adresa: hazer.dana@ubt-uni.net	<u>Për Çështje Operative:</u> Emri: Visar Demiri Titulli: Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit Adresa: Rruga 28 Nëntori, Viti, 61000, Republika e Kosovës Numri i Telefonit: +383 44 199 021 Email Adresa: visar.m.demiri@rks.gov.net

NENI X

Natyra Konfidenciale e Dokumenteve

1. Informacioni që konsiderohet i zotëruar nga secila Palë dhe që është i ndarë ose i zbuluar palës tjetër, dhe është përcaktuar si konfidencial, do të mbahet me besim nga ajo Palë dhe do të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin u zbulua.

NENI XI


Hyrija në Fuqi

1. Kjo MB hyn në fuqi në datën e miratimit në Kuvendin Komunal Viti dhe do të jetë efektive për periudhën deri në përfundimin e projektit, përveç nëse ndërpritet më herët nga ndonjëra Palë në përputhje me Nenin VI ("Ndërprerja") më sipër.
2. Kjo MB përmbanë edhe një Plan Dinamik të Punës që tregon afatet, metodat, aranzhimet, rendin dhe orarin për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me projektin.

NENI XII
E Giithë Marrëveshja

1. Kjo MB paraqet kuptimin e plotë të UBT-së dhe Komunës së Vitisë sa i përket temës kryesore të tij dhe i zëvendëson të gjitha komunikimet me gojë dhe dokumentet paraprake me shkrim.

ME KËTË VËRTETOHET SE, të nënshkruarit më poshtë, përfaqësuesit e autorizuar të UBT-së dhe Komunës së Vitisë, e kanë nënshkruar këtë MB në 4 (katër) kopje origjinale në vendin(et) dhe në datën(at) e shënuara më poshtë:

Për UBT-në	
	
Prof. Dr. Edmond President & R...	Z. Sëkol Haliti Kryetar i Komunës së Vitisë
Vendi:	Vendi: PRISHTINE
Data:	Data:
	

KUSHTET E VEÇANTA TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

- 1. Fillimi i Procesit:** Data e fillimit të procesit është 15.11.2022.
- 2. Përfundimi i Procesit:** Data e përfundimit të aktiviteteve të parapara me këtë MB është më së largu 18 muaj pas datës së fillimit të procesit.
- 3. Plani Dinamik i Punës:** Plani Dinamik i Punës është pjesë e kësaj MB (Shtojca B).
- 4. Zgjatja e periudhës së përfundimit:** UBT mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i obligimeve të dala nga kjo MB vonohet, ose pritet të vonohet, për njërën nga këto arsye:
 - a) Komuna e Vitisë ka dështuar t'i plotësoj obligimet e veta sipas Marrëveshjes,
 - b) Forca Madhore, siç është definuar në Nenin VII.
- 5. Konsekuencat e Shkeljes së Marrëveshjes:**

Pala ka shkelur Marrëveshjen nëse nuk arrinë t'i kryejë obligimet e parapara me këtë MB. Në rast të shkeljes së Marrëveshjes, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) Mbulimi i dëmeve dhe/ose
- b) Ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

- 6. Parimet e përgjithshme të pagesës:** Pagesa nga ana e komunës së Vitisë do të bëhet në 4 faza:

Faza e parë: Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit. Vlera e saj duhet të jetë 20,000.00 (Njëzetmijë) Euro, apo 28.6 % e shumës totale të pagesës.

Faza e dytë: Jo më vonë se 60 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i fazës së Mbledhjes së të Dhënave. Vlera e saj duhet të jetë 15,000.00 (Pesëmbëdhjetë mijë) Euro, apo 21.4 % e shumës totale të pagesës.

Faza e tretë: Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i draftit të parë të HZK. Vlera e saj duhet të jetë 15,000.00 (Pesëmbëdhjetë mijë) Euro, apo 21.4 % e shumës totale të pagesës.

Faza e katërt: Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e pëlqimit nga MMPHI për draftin final të HZK dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Vlera e saj duhet të jetë 20,000.00 (Njëzetmijë) Euro, apo 28.6 % e shumës totale të pagesës.

- 6.1. Pagesa nga Komuna e Vitisë do të bëhet në xhirlogarinë e shënuar më poshtë:**

Emri i përfituesit:	UBT KNBT SHPK
Numri i llogarisë bankare	1300001500005275

7. Kontrolli i kualitetit

Komuna e Vitisë do të kontrollojë punën dhe do t'a njoftojë palën tjetër (UBT-në) për çdo parregullësi të identifikuar. Kjo mund të ndodhë përgjatë gjithë procesit të punës si dhe për një periudhë Nëntëdhjetë (90) ditore pas përfundimit të aktiviteteve të parapara me këtë MB. UBT është e obliguar që të korrigjojë parregullsitë e identifikuara nga ana e Komunës në një afat të arësyeshem i cili nuk do të jetë më i gjatë se 30 ditë pas pranimit të rekomandimit/sygjerimit dhe/apo kërkesës nga ana e Komunës.

8. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

Palët janë pajtuar që çdo mosmarrëveshje së pari ta zgjidhin me bisedime në mënyrë verbal apo marrëveshje me shkrim.

9. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Çdo mosmarrëveshje në mes të palëve e cila mund të lindë gjat implementimit të kësaj MB dhe e cila nuk mund të zgjidhet ndryshe, ajo do të dorëzohet në Gjykatën relevante me natyrën e kësaj MB.

Shtojca A: Grupi Punues Bazë

Anëtarët e Grupit Punues Bazë për bashkëpunim me UBT-në janë:

Komuna ka emëruar stafin e mëposhtëm për Grupin Punues Bazë të projektit Harta Zonale Komunale për Komunën e Vitisë:

Numri.	Emri dhe Mbiemri	Departamenti
1		
2		
3		
4		
5		

UBT ka emëruar stafin e mëposhtëm për Grupin Punues Bazë të projektit Harta Zonale Komunale për Komunën e Vitisë:

Numri.	Emri dhe Mbiemri	Departamenti
1.	Prof.Dr. Edmond Hajrizi	UBT – Menaxhmenti i Lartë
2	Dr.Sc. Visar Baxhuku	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.
3.	Dr.Sc. Hazer Dana	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.
4.	Dr.Sc. Tomor Çela	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.
5.	BSc. Lyra Bakija	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.